

Prill 2018

# EVN ZHURNAL

Gazeta për partnerët  
dhe bashkëpunëtorët

ENERGJIA QË JU NEVOJITET!



Miq të nderuar të kompanisë EVN Elektrofurnizimi,

Jua prezantojmë botimin e ri pranveror të revistës EVN Zhurnal.

Edhe këtë herë, ne do t'j fokusohemi përsëri gamës më të gjerë të temave që kanë të bëjnë me kompanitë në tregun e hapur të energjisë elektrike.

U përpoqëm t'u jepnim përgjigje pyetjeve të cilat më së shpeshti shkaktojnë konfuzione ose interes të kompanitë. I kemi analizuar arsyet për ndjeshmërinë e çmimeve në tregun e hapur të energjisë elektrike, kemi shqyrtuar zhvillimin e pritur të rregullores energjetike në vend dhe ju kemi prezantuar një kompani që ka një angazhim serioz për aplikimin e efikasitetit energjetik në funksionimin (operimin) e çdoditshëm. Ekipi i redaktorëve të revistës gjithashtu ju prezanton një pjesë të specifikave të shërbimit, të cilin EVN Elektrofurnizimi ua ofron konsumatorëve të tij. Ju dëshirojmë një punë të suksesshme në periudhën e ardhshme dhe jemi në dispozicionin tuaj për të gjitha pyetjet dhe idetë tuaja.

Me respekt,  
Ekipi i redaktorëve të revistës EVN Zhurnal



Përmbajtja 04/18

- 03 Jostabiliteti i çmimit të energjisë elektrike në tregun e lirë
- 04 Harmonizimi i legjislacionit energjetik të Maqedonisë me normativat e Bashkimit Evropian
- 05 Mitet më të shpeshta për tregun e liberalizuar
- 06 Intervistë me Gjursel Karadeniz, menaxheri i përgjithshëm, Ramada Plaza
- 07 Modeli i faturës sonë
- 08 Pse EVN Maqedoni Elektrofurnizimi

04



06



05

07


08



# Jostabiliteti i çmimit të energjisë elektrike në tregun e lirë

Funksioni kryesor i kompanive të furnizimit me energji elektrike në tregun e liberalizuar është blerja e energjisë elektrike në tregun me shumicë, e pastaj shitja e saj në tregun me pakicë për konsumatorët e kualifikuar të cilët i kanë zgjedhur ata si furnizues të tyre. Për shkak të ekspozimit të tregjeve me shumicë dhe pakicë, furnizuesit ballafaqohen me rreziqe që dalin nga pasiguritë orare, ditore dhe sezonale në ato tregje, të lidhura kryesisht me jostabilitetin e çmimeve të tregut me shumicë dhe kërkesën e pasigurt të energjisë elektrike, që ndikon drejtpërdrejt ndaj çmimit të energjisë elektrike për furnizimin e konsumatorëve të tyre.

Komponenti që ndikon më shumë ndaj çmimit të fundit të energjisë elektrike, të ofruar për konsumatorët e kualifikuar është çmimi i shitjes me shumicë i energjisë elektrike, i cili mund të jetë jashtëzakonisht jostabil. Në një treg të lirë dhe konkurrues të energjisë elektrike, parimet bazë të ofertës dhe kërkesës formojnë çmimin e tregut. Çmimet e shitjes me shumicë të energjisë elektrike bazohen në kostot e njësisë prodhuese marginale, përkatësisht njësisë së fundit/më të shtrenjtë prodhuese që është e nevojshme për t'u plotësuar kërkesa e energjisë elektrike.



Çmimet mesatare ditore tregojnë variacione të konsiderueshme në 2 vitet e fundit, me disa ndryshime të trendit të çmimeve.

Në përgjithësi, faktorët që ndikojnë ndaj çmimit të shitjes me shumicë mund të grupohen në këtë mënyrë:

## → Menaxhimi ekonomik/shpërndarja dhe kontrollimi i kapaciteteve prodhuese dhe kërkesa e energjisë elektrike:

Mënyra në të cilën përzjerja prodhuese ndikon ndaj çmimit të shitjes me shumicë është komplekse.

Shpenzimet variabile që lidhen me punën (operimin) e centraleve energjetike janë faktori primar në përcaktimin e llojit të centraleve të cilat do të shpërndahen dhe kontrollohen për t'u plotësuar kërkesa e planifikuar e energjisë elektrike, kështu që centralet me kosto më të ulëta variabile zakonisht shpërndahen dhe kontrollohen të para. Me rritjen e kërkesës së planifikuar të energjisë elektrike, shpërndahen dhe kontrollohen në mënyrë të njëpasnjëshme centralet energjetike me kosto më të larta variabile.

Megjithatë, mënyra në të cilën shpërndahen dhe kontrollohen centralet energjetike nga aspekti ekonomik, varet nga kombinimi i disa faktorëve:

- Kostot e lidhura me karburantin të cilin e përdor centrali energjetik;
- Karakteristikat e centralit energjetik;
- Disponueshmëria e burimeve të ripërtëritshme të energjisë;
- Kufizimet sistematike.

Prandaj, efekti i shpërndarjes dhe kontrollimi ekonomik të kapaciteteve prodhuese ndaj çmimit të shitjes me shumicë të energjisë elektrike nuk mund të interpretohet në mënyrë të qartë, duke pasur parasysh vetëm një nga faktorët e lartpërmendur.

Kërkesa më e vogël e energjisë elektrike zakonisht plotësohet me burime më të lira të energjisë, të cilat më së shpeshti përfshijnë centrale energjetike me qymyr dhe centrale energjetike të energjisë bërthamore, ndërsa, kohët e fundit pjesëmarrja e burimeve të ripërtëritshme të energjisë në plotësimin e nevojave të energjisë elektrike është gjithnjë më e madhe si rezultat i trendit të dekarbonizimit të përzjerjes energjetike.

Pas ndërtimit, centralet energjetike të cilat përdorin burimet e ripërtëritshme të energjisë praktikisht nuk kanë shpenzime për karburant dhe për shkak të përfitimeve

ekonomike gjithnjë e më shumë përfshihen në përzjerjen energjetike që është e nevojshme për të mbuluar kërkesën e planifikuar dhe zëvendësojnë një pjesë të centraleve energjetike që përdorin burimet konvencionale të energjisë. Përveç kësaj, në mungesë të një burimi më të lirë të energjisë, sidomos në kohën e kërkesës më të lartë të energjisë elektrike, shpërndahen dhe kontrollohen centralet më të shtrenjta energjetike, që çon drejt një rritjeje të çmimit.

Edhe pse konsiderohet se hidrocentralet kanë kosto relativisht të ulëta variabile, shpërndarja dhe kontrollimi i tyre për plotësimin e kërkesës së planifikuar të energjisë elektrike sipas kushteve ekonomiksht të volitshme është shumë kompleks për disa shkaqe:

- Nivelet aktuale dhe të projektuara të rezervuarëve;

- Faktorët e kushtëzuar nga ambienti;
- Menaxhimi me qëllim të maksimizimit të të ardhurave;
- Nevoja e balancimit, përkatësisht shfrytëzimit të energjisë së ripërtëritshme të cilën e ka aktualisht në dispozicion (ajri dhe energjia e diellit).

Centralet energjetike që punojnë me gaz në shumë tregje rajonale energjetike përdoren për të përmbushur kërkesën në periudhat e ngarkesës së mesme dhe maksimale dhe ato zakonisht janë kapaciteti marginal prodhues që formon çmimin e shitjes me shumicë të energjisë elektrike.

## → Çmimi i karburantit:

Çmimi i rritur i qymyrit dhe gazit i rrit kostot hyrëse të kapaciteteve prodhuese të cilat i shfrytëzojnë këto karburante, duke rritur çmimet e shitjes me shumicë dhe anasjelltas.

## → Kushtet e motit:

Çmimet e shitjes me shumicë mund të rriten në mënyrë të konsiderueshme në kushte të ashpra dhe ekstreme të motit të cilat shkaktojnë:

- Një rritje të konsiderueshme të koston për shkak të ngrohjes dhe ftohjes;
- Një prodhimtari të reduktuar të energjisë nga centralet energjetike të cilat përdorin burimet e ripërtëritshme të energjisë;
- Ndërprerje të mundshme fizike në prodhimin dhe furnizimin me energji elektrike – ndërprerje në punën e centraleve energjetike ose ndërprerje të largpërcësuesve elektrikë.


Të gjithë këta faktorë ndikojnë për rritjen e çmimeve të energjisë elektrike me shumicë, e me këtë edhe të kostove të furnizimit.

## → Disponueshmëria e furnizimit:

Ndërprerjet e planifikuara për shkak të mirëmbajtjes së rregullt të centraleve elektrike (remonteve), si dhe ndërprerjet e paplanifikuara në punën e centraleve energjetike mund të kenë një ndikim të konsiderueshëm ndaj zhvillimit të çmimeve të shitjes me shumicë të energjisë elektrike. Gjatë ndërprerjeve të papritura, shpërndahen dhe kontrollohen kapacitetet më të shtrenjta prodhuese, të cilat mund të shkaktojnë një rritje të papritur të çmimeve të shitjes me shumicë.

Kuptimi i sjelljes dhe specifikave të tregut të shitjes me shumicë dhe pakicë të energjisë elektrike është imperativ në përmbushjen e qëllimit tonë, e ai është mbrojtja e interesave të konsumatorëve tanë aktualë dhe të ardhshëm.

Duke përdorur profesionalizmin, know-how-in dhe përvojën e gjithë Grupacionit EVN, si dhe fuqinë dhe aftësinë tonë financiare për të ballafaquar me rreziqet më të mëdha, ndaj të cilave EVN Maqedoni Elektrofurnizimi si furnizues është ekspozuar në tregun e shitjes me shumicë të energjisë elektrike, ne ju garantojmë se si furnizues i juaji potencial aktual ose në të ardhmen, do të dërgojmë produkte dhe shërbime të ndryshme inovative, të cilat do të sigurojnë një mbrojtje nga jostabiliteti dhe pasiguria e tregut, duke mundësuar një operim të sigurt dhe stabil dhe një planifikim të biznesit tuaj.





# Harmonizimi i legjislacionit energjetik të Maqedonisë me normativat e Bashkimit Evropian

Karakteri specifik i tregjeve të energjisë dhe dinamika e tyre duhet të përcillen me një kornizë adekuate të rregullimit, e cila është në zhvillim të vazhdueshëm. Në këtë kontekst, në periudhën e kaluar kemi qenë dëshmitarë të një zhvillimi të vazhdueshëm të rregullores evropiane energjetike në drejtim të avancimit të marrëdhënieve të tregut dhe sigurimit të të drejtave më të mëdha për konsumatorët e fundit të energjisë. Përvojat dhe normativat që dalin nga Bashkimi Evropian janë një pikë referimi për zhvillimin e tregjeve të energjisë dhe janë një rregullore në vendet anëtare të Bashkësisë Energjetike, një organ i cili është themeluar me lidhjen e Kontratës për themelimin e Bashkësisë Energjetike në Athinë, më 25 tetor 2005. Republika e Maqedonisë, si një nga vendet nënshkruese të Kontratës për themelimin e Bashkësisë Energjetike, e ka ratifikuar të njëjtin në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë me ligj, pas çka Kontrata ka marrë fuqinë e ligjit dhe implementimi i saj ka filluar më 1 korrik 2006.

Obligimi kryesor që del nga marrëveshjet e nënshkuara për të gjitha vendet anëtare të Bashkësisë Energjetike, duke përfshirë edhe për Republikën e Maqedonisë, është harmonizimi i legjislacionit energjetik të vendit me legjislacionin energjetik të Bashkimit Evropian, gjegjësisht me direktivat dhe rregulloret evropiane. Dinamika

me të cilën harmonizimi i legjislacionit implementohet në vendet anëtare varet kryesisht nga karakteristikat e sistemeve kombëtare energjetike dhe nga shkalla e gatishmërisë së brendshme, me theks të efekteve që mund të dalin nga implementimi i masave në ato vende. Megjithatë, harmonizimi i rregullores energjetike është një rrugëtim në një drejtim drejt përgatitjes së integritetit të tregut dhe të gjitha përfitimet që i sjell ajo për konsumatorët.

Në kuadër të atij harmonizimi, Republika e Maqedonisë aktualisht gjendet në fazën e transponimit të së ashtuquajturës pako të tretë të direktivave evropiane, të cilat i kanë në fokus liberalizimin e plotë të tregut të energjisë elektrike dhe gazit natyror, transparencën e rritur tek kryerësit ekskluzivë të veprimtarive energjetike si dhe të drejtat më të mëdha dhe mbrojtjen më të madhe të konsumatorëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror. Kështu, sipas rregullores është paraparë të hapet tregu për të gjithë konsumatorët (duke përfshirë edhe konsumatorët - amvisëritë) të cilët do të kenë mundësinë të zgjedhin një furnizues në tregun e hapur të energjisë elektrike.

Përveç kësaj, si një mekanizëm për mbrojtjen e amvisërive dhe konsumatorëve të vegjël nga lëvizjet dhe rreziqet e tregut, ekziston mundësia që të furnizohen edhe

sipas kushteve të rregulluara nga furnizues të caktuar, të cilët do të jenë bartës të obligimit për të siguruar shërbime publike.

Sa i përket transparencës së operatorëve të sistemeve energjetike si një nga faktorët kryesorë në tregun e energjisë elektrike, direktivat parashikojnë një ndarje ligjore tek operatori e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, ndërsa tek operatori i sistemit të shpërndarjes, i cili në Republikën e Maqedonisë tashmë është ndarë ligjërisht nga ndërmarrja e integruar vertikale, parashikon një ndarje të identitetit të tij korporativ nga ai i ndërmarrjes së integruar vertikale (procedura e quajtur si ribrendim). Theksimi i të drejtave të konsumatorëve është para të gjithash në drejtim të zgjedhjes së lirë të furnizuesve, si dhe trajtimit më të mirë të konsumatorëve në aspektin e vëllimit dhe formës së informacioneve që i marrin ata, procedurave të zgjidhjes së kontesteve, shpejtësisë dhe efektivitetit të proceseve të ndërrimit të furnizuesit dhe e ngjashme.

Transponimi i direktivave dhe rregullores të pakos së tretë nënkupton ndryshimin e Ligjit të energjetikës (miratimi i një ligji të ri) dhe akteve nënligjore. Kjo është një sfidë e veçantë për secilin vend, sepse harmonizimi i rregullores duhet të parashikojë edhe zbatueshmërinë e saj praktike dhe

funksionimin e saj të pandërprerë në tregjet energjetike. Prandaj, kuptohet se duhet të ketë një shkallë të lartë të vëmendjes të pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike për t'u shmangur rreziqet dhe pasojat e mundshme dhe të ketë një parashikueshmëri të rritur gjatë procesit të harmonizimit.

Ambienti i tregut, përveç përparësive që i sjell si rezultat i konkurrencës së rritur, bart me vete edhe rreziqe të caktuara nga lëvizjet e paparashikueshme të tregjeve dhe nga jostabiliteti i çmimeve. Gjithashtu, pjesëmarrja në treg sjell edhe obligime të caktuara për konsumatorët në drejtim të njoftimeve dhe vlerësimeve të kostos, të cilat nëse nuk realizohen sjellin me vete edhe kosto të caktuara. Është e rëndësishme për çdo konsumator që t'i kuptojë në mënyrë të drejtë rreziqet dhe përparësitë e sjelljes së tregut dhe t'i zgjedhë në mënyrë të drejtë partnerët e tij afaristë në mesin e furnizuesve, të cilët do të jenë në gjendje t'ia garantojnë sigurinë në lidhje me sigurimin e nevojave të tija të energjisë elektrike në kushte të parashikueshme. Prandaj, zgjedhja e furnizuesve që kanë një traditë, njohuri dhe përvojë dhe që mund të ballafaqohen me sfidat të cilat i sjell në mënyrë të pashmangshme tregu i energjisë elektrike, është zgjedhja më e mirë për çdo konsumator.

# Mitet më të shpeshta për tregun e liberalizuar

Duke pasur parasysh se liberalizimi i tregut të energjisë elektrike është një proces mjaft kompleks, përvojat nga tregjet e zhvilluara të shitjes me pakicë tregojnë se ekzistojnë keqkuptime të caktuara të konsumatorët. Për një funksionim adekuat të tregut, është e domosdoshme të sqarohen keqkuptimet më të shpeshta me të cilat ballafaqohen konsumatorët e këtyre tregjeve dhe të zvogëlohet pasiguria që lidhet me këtë proces.

**✘ Ndërrimi i shpeshtë i furnizuesit nga ana e konsumatorëve është një shenjë për funksionimin e drejtë të tregut**

**✔** Ndërrimi i furnizuesit shpesh përdoret si një indikator kryesor për funksionimin e drejtë të tregut të shitjes me pakicë. Me mundësinë që konsumatorët të ndërrojnë furnizuesin, furnizuesit janë nën një presion të vazhdueshëm për të ofruar shërbimet më të mira me çmime dhe kushte më të mira. Prandaj, normat e ulëta të ndërrimit të furnizuesit interpretohen si një shenjë se konsumatorët nuk janë të përfshirë sa duhet dhe se konkurrenca nuk është efektive.

Megjithatë, edhe pse normat e ndërrimit të furnizuesit janë një indikator i mirë gjatë vlerësimit të suksesit të tregut, ato nuk mund të analizohen në mënyrë të pavarur, pa marrë parasysh rrethanat e dhëna. Shpesh konsumatorët mund të vendosin për të vazhduar kontratën e furnizimit me furnizuesin e caktuar me një çmim më të lartë, por për shkak të shërbimeve të tjera të ofruara nga furnizuesi. Një rast tjetër është kur konsumatorët bëjnë një ndërrim të produktit të furnizuesit të njëjtë. Ky rast nuk regjistrohet si një ndërrim i furnizuesit, kurse çmimi më i ulët ose kushtet më të mira të produktit, megjithatë janë rezultat i konkurrencës së zhvilluar në treg.

Edhe pse arsyeja më e shpeshtë për ndërrimin e furnizuesit është një mundësi kursimi, duhet të merret parasysh se pjesa që u takon furnizuesve nuk është pjesa e tërësishme e kostos totale të energjisë elektrike. Pjesa tjetër e kostos totale i nënshtrohet rregullimit nga autoritetet përkatëse.

**✘ Llojllojshmëria e produkteve në mënyrë të panevojshme e rrit kompleksitetin e tregut**

**✔** Edhe pse kufizimi i llojit të ofertave dhe produkteve do të ishte i dobishëm në drejtim të thjeshtëzimit të tregut dhe procesit të përzgjedhjes së furnizuesit, megjithatë, para të gjithash duhet të merren parasysh nevojat dhe pritjet e ndryshme të konsumatorëve. Edhe pse pjesa më e madhe e konsumatorëve gjatë përzgjedhjes së furnizuesit kërkojnë kursime të kostove, për



një pjesë të tyre faktori më i rëndësishëm është ndikimi ndaj mjedisit dhe efikasiteti energjetik. Për konsumatorët më të mëdhenj, megjithatë, faktori më i rëndësishëm është mundësia për produkte më komplekse të adaptuara për nevojat e tyre.

Në tregjet e zhvilluara ku nuk ka kufizime ligjore të aftësive të furnizuesve, zbatohen mënyra të ndryshme për mbështetje të konsumatorëve gjatë përzgjedhjes së produkteve më të përshtatshme. Disa prej tyre janë mjete për krahasim të çmimeve të cilat përdorin një gjuhë jo-tekniqe, këshilla të personalizuar nga furnizuesit dhe asociacionet e konsumatorëve,

fushata publike masovike për edukimin e konsumatorëve për tregun e energjisë elektrike dhe e ngjashme.

**✘ Furnizuesit qëllimisht ofrojnë oferta që krahasohen vështirë**

**✔** Konsumatorët që blejnë energji në tregun e liberalizuar kanë nevoja të ndryshme dhe kosto të ndryshme të energjisë elektrike.

Prandaj, është e domosdoshme që furnizuesit të ofrojnë lloje të ndryshme të produkteve, shërbimeve dhe kushteve kontraktuale, të cilat marrin parasysh

kërkesat specifike të konsumatorëve. Ofertat dallohen sipas llojeve dhe periudhave të ndryshme të faturimit, kohëzgjatjes së kontratave e ngjashme.

Me shpjegimin e detajuar të produkteve dhe strukturës më të thjeshtë dhe me prezantimin vizual të ofertave, furnizuesit përpiqen të gjejnë një mënyrë për një vlerësim dhe krahasim më të lehtë të ofertave. Përveç kësaj, autoritetet kompetente në vendet e zhvilluara përpiqen që me një rregullore përkatëse të mbajnë një nivel të lartë të transparencës në lidhje me çmimet dhe ofertat.

**✘ Faturat e energjisë elektrike janë të komplikuar me qëllim t'i hutojnë konsumatorët**

**✔** Shpesh konsumatorët besojnë se faturat për furnizimin me energji elektrike janë mjaft komplekse me qëllim që furnizuesit t'i hutojnë konsumatorët deri në atë masë që disa asociacione të konsumatorëve kanë iniciativë për standardizimin e faturave.

Furnizuesit vazhdimisht i informojnë konsumatorët se një pjesë e madhe e informacioneve të prezantuara në faturë janë në fakt një obligim ligjor, i cili në shumë vende është i rregulluar në mënyrë të rreptë. Ata vazhdimisht ndërmarrin masa për të sqaruar informacionet dhe për t'i bërë faturat më të lehta për interpretim përmes sqarimeve shtesë dhe edukimit nëpërmjet kanaleve të tyre të komunikimit, siç janë faqet e internetit, buletinet dhe e ngjashme.



GURSEL KARADENIZ, MENAXHERI I PËRGJITHSHËM, RAMADA PLAZA

## Me shërbimin e dizajnuar sipas nevojave tona, EVN Furnizimi na mundëson t'i përkushtohemi zhvillimit

→ **EVN Zhurnal:** Cilat janë masat e efikasitetit energjetik që janë të implementuara në kompaninë tuaj dhe cilat janë planet tuaja për të ardhmen në atë sferë?

**Gursel Karadeniz (Gürsel Karadeniz):** Hoteli Ramada Plaza dhe Kazinaja Princes janë komplekse luksoze, të cilat u ofrojnë përmbajtje të ndryshme mysafirëve të tyre. Hoteli shtrihet në një hapësirë me madhësi prej 18.324 metrave katrorë, i shtrirë në tri kate, me 131 dhoma, ndërsa kemi në dispozicion edhe dy restorante, një bar, një diskotekë, një sallë banketi, një kazino dhe një spa qendër. Duke marrë parasysh përmbajtjet e pasura që ua ofrojmë mysafirëve tanë, të cilat janë në përputhje me trendet më të larta botërore në sferën e hotelerisë, ne jemi në grupin e konsumatorëve të mëdhenj të energjisë elektrike dhe ky segment është një element i rëndësishëm i kostove tona totale. Kjo është arsyeja se pse ne po punojmë seriozisht në alternativa të ndryshme për kursimin e energjisë elektrike, përkatesisht në zbatimin e efikasitetit energjetik, nëpërmjet vetëdijes së rritur, inovacionit dhe punës ekipore.

→ **EVN Zhurnal:** Duke pasur parasysh se kompania juaj katër vite është pjesë e tregut të liberalizuar të energjisë elektrike, a mund të na thoni se cilat janë përfitimet nga ai?

**Gursel Karadeniz:** Duke qenë në tregun e liberalizuar ka mundësuar që Hoteli Ramada Plaza dhe Kazinaja Princes të jenë pjesë e ambientit konkurrues, që jep të drejtën e zgjedhjes për të blerë energji elektrike. Përveç kësaj, ky proces na ka mundësuar të zgjedhim produktet më të favorshme dhe kushtet kontraktuale për kompaninë tonë me një çmim të tregut. Pas hulumtimeve dhe analizave të nevojshme që janë bërë në lidhje me shërbimet dhe çmimin e energjisë elektrike që ne furnizojmë, kemi marrë një vendim të favorshëm gjatë përzgjedhjes së furnizuesit të energjisë elektrike.

→ **EVN Zhurnal:** Si partner i juaji në tregun e hapur e keni zgjedhur kompaninë EVN Elektrofurnizimi. Si është përvoja juaj nga bashkëpunimi i deritanishëm?

**Gursel Karadeniz:** Bashkëpunimi me kompaninë EVN Elektrofurnizimi si furnizues i yni i energjisë elektrike ofron përfitime për të dyja palët. EVN Elektrofurnizimi na ofron një zgjedhje në aspektin e produkteve dhe kushteve kontraktuale të furnizimit dhe adapton ato me nevojat tona. Është gjithashtu veçanërisht e rëndësishme për ne që EVN Elektrofurnizimi na siguron informacione për lëvizjen e çmimeve të tregut të energjisë elektrike në kohë reale dhe na jep një pasqyrë të vazhdueshme në strukturën e kostove tona të energjisë elektrike.

Deri më tani, EVN Maqedonia Elektrofurnizimi u dëshmuar si një partner, i cili nëpërmjet kushteve të volitshme të furnizimit, këshillave dhe konsultimeve profesionale, na mundëson t'i optimizojmë kostot operative. Kompania na garanton kushtet për të gjithë periudhën e kontratës, që për ne do të thotë një siguri në planifikimet financiare. Në një treg të këtille dinamik dhe të shpejtë, siguria financiare ka një rëndësi të paçmueshme për punën e kompanisë sonë.

→ **EVN Zhurnal:** Në cilin drejtim po planifikoni të zhvillohet kompania juaj në të ardhmen?

**Gursel Karadeniz:** Fokusi kryesor i kompanisë sonë është depërtimi i vazhdueshëm në tregje të reja dhe rinovimi i produkteve dhe shërbimeve me qëllim që të zbulojmë klientë potencialë dhe të promovohemi në mjedisin ku veprojmë. Ekzistojmë për t'i plotësuar nevojat dhe kërkesat e klientëve tanë, duke u ofruar atyre shërbime profesionale dhe cilësi, e njëkohësisht të mos e dëmtojmë mjedisin në të cilin veprojmë, por përkundrazi ta ndihmojmë atë me realizimin e projekteve të sferave të ndryshme.




EVN Elektrofurnizimi na ofron një zgjedhje në raport me produktet dhe kushtet kontraktuale të furnizimit dhe i adapton ato sipas nevojave tona



# Modeli i faturës sonë

Fatura e energjisë elektrike mundëson pasqyrën e detajuar të informacioneve për sasinë dhe çmimin e energjisë së harxhuar elektrike, ndërsa një kopje e faturës mund të fitohet edhe në gjuhën shqipe



- A** – Kontakt informacioni jonë, si dhe llogaritë bankare
- B** – Emri dhe adresa e konsumatorit
- C** – Adresa ku e dërgojmë faturën
- Ç** – Periudha e faturimit për të cilën i referohet shuma dhe data e lëshimit të faturës
- D** – Numri i konsumatorit është numër unik me të cilin ju identifikojmë në sistem. Ju lutemi mbani këtë numër në dispozicion çdo herë që të kërkoni shërbim nga ne. Një kompani mundet të ketë më shumë numra të shfrytëzuesit.
- DH** – Adresa e vendit të konsumit për të cilën adresohet fatura. Në qoftë se fatura do jetë për më shumë se një vend shpenzimi, do të jetë e shënuar këtu.
- E** – Numri i vendit të konsumit është numër unik për çdo vend të konsumit. Një vend konsumi mund të ketë vetëm një numër i vendit të konsumit, kurse një numër konsumi mund të ketë më shumë se një numër vendi të konsumit. Numri i kontratës është shenjë specjale në biling sistemin tonë.
- Ë** – Shuma e përmbledhur e faturës për energjinë e dorëzuar në të gjitha pikat e konsumit të përfshirë në këtë faturë. Informacione më të hollësishme janë në dispozicion në faqet e ardhëshme të faturës.
- F** – Tarifa për shfrytëzimin e tregut të energjisë elektrike është e tarifë e rregulluar me çmimi fiks për kWh të miratuar nga Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe faturohet nga çdo pjesëmarrës në treg. Kjo tarifë ndryshon çdo vit dhe është e aplikueshme nga 01.07.
- G** – Tarifa për përdorimin e energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë.
- GJ** – TVSH prej 18%.
- H** – Gjatë pagesës thiruni në numrin e shënuar këtu.
- I** – Detaje për vendin e konsumit.
- J** – Te dhëna për konsumin e energjisë elektrike në periudhën e caktuar. Gjendja e vjetër krahasohet me gjendjen e re dhe dallimi llogaritet për tarifën e lartë (TL) dhe të ulët (TU).
- K** – Informata të detajuara reth sasisë, çmimit dhe shumës për energji elektrike sipas kontratës, energji elektrike nga burime të ripërtëritshme dhe tarifa shtesë.
- L** – Informata të përmbledhur për energjinë elektrike të konsumuar dhe shumën e faturuar për të gjitha vendet e konsumit të ndara në tarifa.
- LL** – Informata për përqindjen dhe çmimin e energjisë elektrike nga burime të energjisë të ripërtëritshme, të definuar nga ana e Komisionit Rregullator i Energjetikës.

Konsumi i energjisë elektrike në tarifën e lartë

Konsumi i energjisë nga burime të ripërtëritshme në tarifën e lartë

Konsumi i energjisë elektrike në tarifën e ulët

Konsumi i energjisë nga burime të ripërtëritshme në tarifën e ulët

Fatura nr. 0000123456-1 – Informata të detajuara

Numri i konsumatorit: 123456758 Adresa e vendit konsumues: RRUGA 10

Numri i vendit konsumues: 123123123123

Numri i kontratës: AB\_123456758

Periudha e përllogaritjes: 01.07.2016 – 31.07.2016

Numri i pikës së leximit: MK0001000000000000000000000000000011111

**Vlerat e lexuara për periudhën 01.07.2016 – 31.07.2016**

Matësi /tarifa	Gj. e vjetër	Gj. e re	Ndryshimi faktori	Vlera e përllogaritur	kWh të miratuar	Vlera e përl në total
010480820/ A TL	100.000	150.000	50.000 3000	15.000	15.000	15.000
010480820/ A TU	50.000	150.000	100.000 3000	30.000	30.000	30.000

**Tarifat për shitje të energjisë elektrike dhe fuqisë së angazhuar**

Përshkrimi	Periudha	Njesia	Sasia	çmimi	Den.
AKTIVNA VT ( AVT )	01.07.2016 – 31.07.2016	kWh	14.221,50	3,00	42.664,50
AKTIVNA VT ( AVT ) OIE		kWh	778,50	6,7387	5.246,08
AKTIVNA NT ( ANT )	01.07.2016 – 31.07.2016	kWh	28.443,00	3,00	85.329,00
AKTIVNA NT ( ANT ) OIE		kWh	1.557,00	6,7387	10.492,16
<b>Totali i energjisë elektrike të konsumuar me çmimin e kontraktuar</b>		kWh	42.664,50		127.993,50
Totali i energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme		kWh	2.335,50	6,7387	15.738,23
Kompensimi për shfrytëzimin e tregut të energjisë elektrike		kWh	45.000,00	0,0089	400,50

**Pasqyrimi i tarifave për shitje të energjisë elektrike dhe fuqisë së angazhuar për të gjithë vendet konsumuese**

Përshkrim	Periudha	Njesia	Sasi	çmimi	Den.
Energji aktive TL ( ATL )	01.07.2016 – 31.07.2016	kWh	14.221,50	3,00	42.664,50
Energji aktive HT ( ATU )	01.07.2016 – 31.07.2016	kWh	28.443,00	3,00	85.329,00
<b>Energji aktive nga burimet e ripërtëritshme</b>			2.335,50	6,7387	15.738,23
<b>Total për të gjitha vendet e konsumit :</b>					<b>143.731,73</b>

Kompensim për përdorimin e tregut të energjisë elektrike 7/2016: 45.000,00 0,0089 400,50

Energji elektrike e konsumuar dhe fuqija e angazhuar: 143.731,73  
Kompensimi për shfrytëzimin e tregut të energjisë elektrike: 400,50  
Baza tatimore: 144.132,23  
Tatimi mbi vlerën e shtuar TVSH 18%: 25.943,80  
Vlera totale e faturës: 170.076,00

çmimi mesatar për energji elektrike nga burime të rinovueshme për 07/2016: 6,7387 den / kWh  
Përqindja e pjesës së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit preferenciale të energjisë elektrike 1/2016: 5,19 %

Shuma për energjinë elektrike të harxhuar në tarifën e lartë

Shuma për energjinë elektrike nga burime të ripërtëritshme në tarifën e lartë

Çmimi sipas kontratës për tarifën e ulët

Shuma për energjinë elektrike nga burime të ripërtëritshme në tarifën e ulët

Çmimi sipas kontratës për tarifën e lartë

Çmimi për energjinë nga burimet e ripërtëritshme në tarifën e lartë

Çmimi për energjinë nga burimet e ripërtëritshme në tarifën e ulët

Çmimi sipas kontratës për tarifën e ulët



# Pse EVN Maqedoni Elektrofurnizimi

EVN Maqedoni Elektrofurnizimi është kompania lider për furnizimin me energji elektrike në tregun energjetik të Maqedonisë. Me ekspertizën e saj dhe ekipin e përkushtuar dhe të motivuar, EVN Maqedoni Elektrofurnizimi me veprimet e saja të çuditshme tregon se ka një rol kyç në zhvillimin e tregut të lirë të energjisë elektrike në Republikën e Maqedonisë.

Konsumatorët janë në fokusin e vëmendjes sonë dhe me përkushtimin tonë të çuditshëm dhe zgjidhjet inovative sigurojmë një zhvillim të sigurt për ta. Siguria dhe disponueshmëria është motoja e veprimit tonë!

## Njohuritë dhe përvoja

Si pjesë e Grupacionit EVN, e cila ka një përvojë dhjetëvjeçare në furnizimin e energjisë elektrike në tregun e lirë dhe shërben pothuajse 4.5 milionë konsumatorë, EVN Maqedoni Elektrofurnizimi ka në dispozicion një ekspertizë dhe përvojë të madhe që e vë në dispozicion për konsumatorët e saj dhe siguron shërbime të sigurta dhe të cilësisë së lartë në tregun e lirë të energjisë elektrike.

## Qasja e adaptuar

Ne u ofrojmë konsumatorëve tanë shërbime të adaptuara për nevojat e tyre dhe të dizajnuara sipas karakteristikave të veçanta të

aktiviteteve të tyre afariste. Në këtë mënyrë, secili konsumator merr një shërbim që i plotëson në mënyrë optimale nevojat e tija për energji elektrike. Menaxherët tanë për konsumatorët afaristë që kujdesen për klientët nëpër rajonet, njohin specifikat dhe nevojat e tyre dhe ofrojnë zgjidhje adekuate me një qasje individuale. Menaxherët për konsumatorët afaristë janë në dispozicion në çdo kohë për shërbimet këshillimore, e ky segment avancohet vazhdimisht në drejtim të krijimit të një marrëdhënie më të mirë me konsumatorët.

## Stabiliteti dhe fleksibiliteti

I takojmë nevojat e ndryshme të konsumatorëve tanë dhe mundësojmë

një kombinim optimal të stabilitetit dhe fleksibilitetit në biznesin dhe marrëdhëniet kontraktuale, duke marrë parasysh kushtet e ndryshueshme në treg.

Mbështetja shtesë Përveç furnizimit me energji elektrike, EVN Maqedoni Elektrofurnizimi është një kompani që ofron mbështetje dhe edukim në procesin e arritjes së efikasitetit më të madh energjetik në punën e konsumatorëve të saj. Në këtë mënyrë, konsumatorët e kompanisë EVN Maqedoni Elektrofurnizimi i optimizojnë kostot e tyre për energji elektrike, duke zbatuar parimet për efikasitetin më të madh energjetik, me çka rritet edhe konkurrencën e tyre në tregjet ku janë të pranishme.

## KANALET E KOMUNIKIMIT ME KOMPANINË EVN ELEKTROFURNIZIMI

